

Politika e Pjesmarrjes se aktoreve kryesore dhe paleve te interesuara.

1. Parathënie

SAICM si një përfaqesje strategjike ndërkombëtare u mandatua nga UNEP dhe u nxit nga mbledhja botërore e Johannesburgut mbi zhvillimin e qëndrueshëm në 2002 si dhe samiti botëror në Neë York në Shtator 2005. Ajo u nis nga një iniciativë e i një komiteti përgatitor shumëpalësh i rimbledhur nga UNEP-i, IFC-ja dhe IOMC-ja.

Përfaqesja strategjike ndaj menaxhimit të kimikateve u përdor dhe u shfaq në konferencën ndërkombëtare të menaxhimit të kimikateve në Dubai 2006. SAICM paraqet një strategji gjithpërfshirëse ndaj problemeve të menaxhimit të kimikateve në rang kombëtar dhe global.

Arritja kryesore që synohet është mirëmenaxhimi i kimikateve gjatë gjithë ciklit jetësor të tyre me qëllim që deri në vitin 2020 kimikatet të pëdoren dhe prodhohen në mënyra të tëilla që të minimizohen konsiderueshëm efektet që ato shkaktojnë ndajshëndetit njerzor dhe mjedisit. E parë nën këtë këndvështrim SAICM përmbledh tre dokumente kryesore

1. Deklaratën e Dubait ku riafirmohet marrëveshja në rang botërorë për ndërmarrjen e veprimtarive të nevojshme për të mbrojtur shëndetin publik dhe mjedisin të shkaktuara nga përdorimi i kimikateve gjatë ciklit të tyre jetësor. Në paragrafin e tij hyrës Deklarata e Dubait thekson se mirkuptimi global në menaxhimin e kimikateve është një element thelbësor për arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm. Kjo Deklaratë identifikon probleme të tilla si : mungesa e kapaciteteve për menaxhimin e kimikateve në vendet në zhvillim dhe për vendet me ekonomi tranzitore; vartësia e pesticideve në bujqësi ; ekspozimi i punëtorëve ndaj kimikateve të rrezikshme; si dhe problemet që shkaktohen nga kimikatet e dëmet afatgjata që shkaktojnë ato në shëndetin e njeriut dhe në mjedis.

2. Strategjia e Politikave Gjithpërfshirëse (OPS) , e cila nxit dhe nxjerr në pah qëllimin e SAICM, nevojat që duhen adresuar dhe objektivat për reduktimin e rrezikut, nevojat për dije dhe informacione, për qeverisje, për ndërtim kapacitetesh dhe bashkpunim teknik dhe trafikim i paligjshëm ndërkombëtar, si dhe për parimet e tjera si dhe rregullimet e caktuara financiare dhe institucionale. Kjo Strategji përcakton problematikën e kuadrit ndërkombëtar të politikave për kimikatet si dhe mungesën e kapaciteteve nga ana e shumë shteteve për të siguruar mirëmenaxhimin e kimikateve si dhe e dhënien e informacionit të nevojshëm për shumë kimikate në përdorim.

3. Plani Global i Veprimtarive në të cilën përcaktohen fushat e aktiviteteve për implementimn Përqasjes Strategjike. Plani Global i Veprimtarive të SAICM u aprovua me një miratim të përbashkët për përdorim dhe zhvillim të përbashkët si një “mjet pune” dhe dokument udhëzues për mirëmenaxhimn e kimikateve dhe implementimine SAICM.

Tabelat e mëposhtme janë thjesht draft, objekt I diskutimit në mbledhje dhe I rishikimit nga pjesëmarrësit:

Problematika	Boshllëqet dhe çështjet aktuale	Masa që mund të ndërmerren për ti korigjuar gabimet
1. Input i aktorëve të interesuar dhe fidbeku (përgjigja)	Input i palëve të ndryshme nuk është i vazhdueshëm dhe shpesh herë është i diktuar nga ngjarjet të ndryshme	Promovim I përfshirjes së palëve, ndërgjegjësimit, trajnime
	Aftësitë, eksperiencat dhe ekspertizat e palëve të ndryshme nuk mbliidhen sic duhet, sidomos në sektorin privat	Promovim I aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve në sektorin privat Ndihmë financiare dhe teknike për formimin e grupeve të interesit për çështjet e kimikateve Forcim I zbatimit të detyrimeve të industrise
2. Shkëmbimi I të dhënave dhe shpërndarjes së informacionit palëve të interesuara	Mungesë apo mangësi e të dhënave për menaxhimin e kimikateve dhe sigurinë kimike	Ngritja e bazave të të dhënave, promovimi I mekanizmave të shkëmbimit të informacionit Infrasrtuktura mungon n(ne nivel local)
3. Interesat e palëve të të ndryshme	Vëmendje duhet t’u kushtohen çështjeve që kanë rëndësi për publikun	Duhet mbajtur parasysh sidomos gjatë hartimit dhe zbatimit të një plani veprimi
4. Rolet e aktorëve të ndryshëm	Mbivendosja apo mungesa e roleve të aktorëve të ndryshëm	Rishikimi I legjislacionit Hartimi I ToR për aktorët kyc dhe aktorët e tjerë, që të kenë ndarje të qartë të roleve dhe përgjegjësi
5. Pjesëmarrja e gupeve jo-qeveritare	Ekspertize e kufizuar	Trajnime

Fushat e punes	Agjencia/ aktori kryesor	Agjenci/ aktore te tjere
1. Vlerësimi i menaxhimit të kimikateve kombëtare për të identifikuar mangësitë dhe për të nxjerrë prioritetet	Projekti SAICM	Ministritë dhe agjencitë e përfshira ne menaxhimin e kimikateve OJF Universitetet , industria
2. Mbrojtja e shëndetit të njeriut	Ministria e Shendetësisë	MSh, IShP, DShP-të e rretheve, Inspektorati Sanitar Shteteror Pushteti vendor, OJF-të, OBSH, media
3. Fëmijët dhe siguria ndaj kimikateve	MSh	MSh, MASH, IShP - Departamenti I Promocionit, UNICEF, OJF-te, media, IZHA (Inst. Zhvillimit te Arsimit)
4. Shëndeti dhe siguria në punë	MPCSShB,	Inspektoratet (Sanitar dhe I Punes), MMPAU (per aksidentet), MSh, IShP, Sindikatat, ILO (International Labour Organization) Sektori privat, industrite,
5. Implementimi i Sistemit te Harmonizuar Botëror të Klasifikimit dhe Etiketimit të Kimikateve.	MMPAU (Agjencia e Kimikateve)	Industria, MSh, MBUMK, Doganat (CLP)
6. Menaxhimi i rrezikut të pesticideve me toksicitet të lartë dhe zbutja e efekteve të tyre	MBUMK	ISUV. MSh, Qendra Kombetare e Licensimit, Inspektoret, OBSH , importuesit, dogana, Komisioni I Regjistrimit te PMB-ve, QKR (QK Regjistrimit)
7. Programet për pesticidet	MBUMK	ISUV, Universitetet (UBT), IShP, DShP-te Shoqatat
8. Shëndeti i dobësuar dhe rreziqet mjedisore të pesticideve	MBUMK	MSh, MMPAU, ISUV, Universitetet (UBT), IShP, DShP-te Shoqatat
9. Prodhimi pastër	MMPAU	METE, UNIDO, ECAT, AMP, MBUMK, Industria
10. Rehabilitimi i zonave të ndotura	MMPAU	METE, Donatoret , AMP
11. Plumbi në benzinë	MMPAU	Inspektorati Qendror Teknik, laborator i Hidrokarbureve, MPPT do e heqim (nuk ka te dhena per prodhimin vendas)

Fushat e punes	Agjencia/ aktori kryesor	Agjenci/ aktore te tjere
12. Praktikrat e mira bujqësore	MBUMK	UBT, Shoqatat e fermereve
13. Substanca persistente, bioakumulative dhe toksike; substancat shumë persistente dhe shumë bioakumulative; kimikate që janë kancerogjene apo mutagjene Apo ato që kanë efekte negative, ndër të tjerash, te sistemi riprodhues, endokrinë, imunitar apo nervor. Ndotësit organikë persistent.	MMPAU	MBUMK, IShP, Industria
14. Mërkuri si dhe kimikate të tjera të shqetësimit global; kimikate të prodhuara dhe të përdorura në volume të mëdha ; kimikate me përdorim të shpërndarjes së gjerë si dhe kimikate të tjera të problematikës në nivelet kombëtare	MMPAU	MSh, METE,
15. Vlerësimi i riskut, menaxhimi dhe komunikimi	MSh, MMPAU	AMP, IShP, IHR, Media , OJF-te
16. Menaxhimi i mbetjeve(dhe minimizimi i efekteve të tyre)	MMPAU	PPT, AMP, Agjencite rajonale te mjedisit Sektori privat
17. Formulimi i masave parandaluese për të zbutur impaktin e urgjencave kimike në shëndetin njerzor dhe mjedisor	MB, MMPAU	IShP-IHR (International Health Regulations) , AMP, kryqi I Kuq, QKOEK (Qendra kometare operacionale ..)
18. Kërkime, monitorime dhe të dhënat	MMPAU	ISUV, AMP, ISHP, MSh, Institutet, Universitetet, Dogana
19. Gjenerimi dhe disponibiliteti i të dhënave për rreziqet	Zyra e Kimikateve	AMP, ARM-te, MSh, Industria
20. Promovimi i pjesmarrjes së industrisë dhe përgjegjësitë	Dhomat e Tregtise	METE, AIDA (Agjencia per Zhvillim industrial)
21. Menaxhimi dhe shpërndarja e informacionit	Zyra e Kimikateve	Drejtoria e Pergjithshme e Doganave INSTAT, Ministrite e linjes
22. Cikli jetësor	Zyra e Kimikateve	MSh, MMPAU, METE, MBUMK, doganat, MPPT, dhoma e tregtise, Shoqata e Mbrojtjes se Konsumatoreve
23.Regjistrat e clirimeve dhe transferimeve të ndotësve; krijimi i regjistrave kombëtar dhe ndërkombëtar	MMPAU	AMP, Inspektorati I Mjedisit, ARM-te, Industria
24. Edukimi dhe trajnimi (ndërgjegjësimi i publikut)	IShP- Departamenti I Promocionit	MMPAU, MASH, OJF-te , media, Fakulteti I Mjeksise, Departamenti I Shendetit Publik
25. Pjesmarrja e palëve të interesuara	Komitet ndersektorial	Ministrite e linjes, OJF-te, Universitetet, industria, etj.

Fushat e punes	Agjencia/ aktori kryesor	Agjenci/ aktore te tjere
26. Implementimi i programeve kombëtare të integruara për mirëmenaxhimin e kimikateve ne nivel kombëtar në një formë sa më elastike	Zyra e Kimikateve	Ministrite e linjes, UNDP, OBSH, UNIDO, OSCE,
27. Marreveshjet ndërkombëtare	MMPAU	Ministria e jashtme, Ministrite e linjes
28. Konsiderata ekonomike dhe sociale	Ministria e Finances	Ministrite e linjes, sektori privat (industria)
29. Aspekte ligjore, të politikave dhe institucionale	MMPAU	Zyra e Kimikateve, projektet e perafrimit te legjislacionit me ate te BE
30. Detyrimet dhe kompensimi	Inspektorati I Mjedisit	AMP, MF, MMPAU, MSH, MBUMK, MPCSShB
31. Arritjet në shënimin e stoqeve (Zhvilloni indikatorë objektivë për vlerësimin e ndikimit të kimikateve në shëndetin njerzor dhe mjedisor)	MSh	MMPAU, ISHP, AMP
32. Zonat e mbrojtura	MMPAU	AMP, ARM, Pushteti vendor
33. Parandalimi i trafikut të jashtligjshëm të produkteve toksike dhe të rrezikshme	Doganat	Inspektoratet ne pikat kufitare
34. Tregëtia dhe mjedisi	METE	MMPAU, MBUMK, MSh, Inspektoratet
35. Shoqëria civile dhe grupet e interesit të organizatave jo-qeveritare(OJQ)	MMPAU, Zyra e kimikateve	Komiteti ndersektorial
36. Ndërtimi i kapaciteteve për të mbështetur veprimtarinë kombëtare	MMPAU	MSh, AMP, ISHP, Universitetet, OJF-te, Institucionet